

## NË EMËR TË POPULLIT

**Gjykata e Apelit e Kosovës** – kolegji i përbërë nga gjyqtarët, Rasim Rasimi, kryetari i kolegjit, Shqipe Qerimi e Gani Zabeli, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Ilmije Zeka, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.H. nga fshati ..., komuna e Mitrovicës, për shkak të kryerjes së veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me par.1. nënpar. 1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të të akuzuarit, av. B.S., të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, P.nr.633/2017 të datës 20.06.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 06.07.2017, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit A.H., av. B.S., kurse aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, P.nr.633/2017 i datës 20.06.2017, **vërtetohet**.

## A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, me aktvendimin P.nr.633/2017 i datës 20.06.2017, të akuzuarit A.H. për shkak të kryerjes së veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me par.1. nënpar. 1.4 KPRK-së, i ka shqiptuar Masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim, në institucionin e kujdesit shëndetësor, në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve. Të akuzuarit i është vazhduar masa e paraburgimit deri në plotfuqishmërinë e aktvendimit por jo më shumë se koha e masës së shqiptuar në aktvendimin mbi masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në ndalim. Të akuzuarit Agron, koha e kaluar në paraburgim prej datës 16.05.2017 e tutje si dhe trajtimi psikiatrik në SHSKUK –Instituti i Psikiatrisë Forenzike, i është llogaritur në kohëzgjatjen e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor në afatin kohor të caktuar prej 6 muaj. I akuzuari do të dërgohet në Institutin e Psikiatrisë Forenzike të Shërbimit Spitalor dhe Klinikë Universitare të Kosovës në Prishtinë dhe do të shtrihet në këtë Institut deri në përfundimin e kohëzgjatjes së masës së caktuar më lartë. Instituti i Psikiatrisë Forenzike i SHSKUK në Prishtinë, është obliguar që ta informojë gjykatën me mbarëvajtjen e këtij trajtimi të detyrueshëm psikiatrik me ndalim, një herë në muaj pas pranimit të të akuzuarit në këtë Institut, si dhe me rastin e pranimit duhet të njoftohet gjykata. I akuzuari është liruar nga pagesa e shpenzimeve procedurale penale dhe paushallë dhe të njëjtat bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë mbrojtësi i të akuzuarit, av. Bekim Sfishta, për shkak të vendimit mbi shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë të aprovojë ankesën si të bazuar, aktvendimin e atakuar me ankesë ta ndryshojë ashtu që të akuzuarit ti shqiptoj masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri.

Prokurori i Apelit, me shkresën PPA/II.nr.770/2017 datë 30.06.017, ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktvendimi i ankimuar, të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioi aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

**- ankesa nuk është e bazuar.**

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk kundërshtohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi në këtë aspekt komfor dispozitës së nenit 394 të KPP dhe konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit.

Gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, prandaj aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore.

Sa i përket vendimit mbi shqiptimin e Masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor, me ankesë mbrojtësi i të akuzuarit pretendon se gjykata e shkallës së parë nuk ka vendosur drejtë, sepse kjo masë është në shpërputhje me veprën penale dhe me rrethanat e rastit konkret, në shpërpjesëtim me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë të mbrojturit të tij dhe se masa e shqiptuar është e pa nevojshme. Sipas ankesës, i akuzuari asnjëherë më parë nuk ka ra ndesh me ligjin, prandaj konsideron se në përputhje me personalitetin e të akuzuarit, intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë të të mbrojturit të tij, do të ishte masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri për aq kohë sa është e nevojshme dhe sipas rrethanave të rastit.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me shqiptimin e Masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri, nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të masës së lartcekur në mënyrë të plotë dhe gjithë përfshirëse i ka konstatuar dhe drejtë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat në pajtim me nenet 312, 513 dhe 514 të KPPK dhe neneve 88 e 89 të KPRK, me ç' rast ka vlerësuar Raportin e ekipit mjekësor të Institutit të psikiatrisë forenzike pranë Shërbimit Spitalor dhe Klinikë Universitare të Kosovës, në përbërje prej Dr. Sci.- G.H. dhe doktorëve, B.O., J.Z. dhe F.D. i përpiluar me datë 07.06.2017, pas ekzaminimit spitalor të të akuzuarit nga data 17.05.2017 deri me 10.06.2017 si dhe deklaratën e dr. B.O., dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 15.06.2017. Në bazë të Raportit të lartcekur dhe deklaratës së dr. B.O., gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se i akuzuari vuan nga një çrregullim i përhershëm psikik i cili sipas klasifikimit ndërkombëtar të sëmundjeve quhet Shizofreni paranoide dhe kodohet me shifrën F20, se karakteristikë e këtij çrregullimi është përmirësimi dhe keqësimi i gjendjes mendore, se simptomat e këtij çrregullimi janë bindjet e gabueshme apo deluzionet e raportit, çrregullimi i sjelljes, iritabilitetit dhe ulja e pragut të tolerancës në situata frustative. Sipas Raportit, çrregullimi mund të shoqërohet në të njëjtën kohë me çrregullime të sferës perceptive siç janë halucinacionet auditive dhe vizive. Sipas dr.O., duke marrë parasysh kohën dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale, ekipi i mjekëve ka ardhur në përfundim se i akuzuari në atë kohë ka pasur një përkeqësim të sëmundjes bazë me ç' rast mundësia

e tij për të kontrolluar veprimet e tij, ka qenë e zvogëluar. Dr. B.O., në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se sipas konstatimit të ekipit të mjekëve, i akuzuari ka nevojë për trajtim në institucion shëndetësor dhe se institucioni më adekuat për të akuzuarin është Instituti i Psikiatrisë Forenzike në Prishtinë sepse në bazë të të dhënave anamnesticke dhe heteroamnesticke, të dhënave nga tentim trajtimet e mëhershme, është kuptuar se i njëjti në trajtimin ambulator nuk do ta përdorë terapinë në mënyrë adekuate dhe se masa e trajtimit të detyrueshëm me ndalim në IPFK, është propozuar për të mirën e të ekzaminuarit.

Kjo gjykatë, vlerësimin e këtyre të rrethanave relevante të vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë e pranon si të drejtë dhe të bazuar në ligj, prandaj duke pasqyruar të gjitha rrethanat që i ka konstatuar dhe drejtë i ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar faktin se në rastin konkret i akuzuari i ka shkaktuar lëndime të lehta prindit të tij me të cilin jeton në një bashkësi familjare e i cili në shqyrtimin gjyqësor shfrytëzoi të drejtën e tij që si prind i të akuzuarit të mos dëshmojë, në kuptim të nenit 127 të KPPK, duke vlerësuar edhe faktin se masa e shqiptuar është në interes të mbrojtjes dhe përmirësimit të gjendjes psikike të tani të akuzuarit si dhe në të mirë të rrethit ku jeton ai e duke pasqyruar faktin se Instituti do të njoftojë gjykatën lidhur me procesin në atë mënyrë që kur të arrihet efekti i përcaktuar nga ekipi multidisciplinar, do të kërkohet ndërrimi i masës së shqiptuar me trajtim të detyrueshëm psikiatrik në liri.

Kolegji penal i kësaj Gjykate vlerëson se masa e shqiptuar në rastin konkret është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si dhe me gjendjen e tij psikike aktuale dhe se masa e shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë është momentalisht më se e nevojshme për të akuzuarin, fillimisht duke e pasqyruar shërimin e tij mental, shmangjen e përsëritjes së kryerjes së ndonjë vepre të re penale dhe ruajtjen e rrethit në të cilin jeton i akuzuari.

Nga sa u tha më lartë në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PA1.nr.752/17 me datë 06.07.2017**

**Bashkëpunëtorja profesionale**  
**Ilmije Zeka**

**Kryetari i kolegjit-gjyqtari**

**1. Rasim Rasimi**

**Anëtarët e kolegjit:**

**2. Shqipe Qerimi**

**3. Gani Zabeli**